



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:151321

Datë: 22.04.2024

Numri i dokumentit: 05603990

C-III - 15- 0700

Paditës: H B, Prizren .

Kundër

Të paditurit: NSH DLB „ Lavërtari Blegtori ” e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, në Prishtinë, rr. „Driton Hoxha ” 55, përfaqësuar nga Gresa Krasniqi .

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Specializuar, i përberë nga Gjyqtari Kryesues Hasim Sogojeva dhe Gjyqtarët anëtar Gazmend Sylaj dhe Diellza Hoxha , pas mbajtës së seancës dëgjimore publike, më dt. 25 mars 2024 , më dt. 16 prill 2024 mori këtë :

**A K T G J Y K I M
PËR MOSPARAQITJE**

- I. HEDHET ankesa e paditëses H B, kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit për NSH DLB „ Lavërtari dhe Blegtori ” , PRZ 009- 0410, dt. 12.10.2015.**
- II. Secila palë i heqë shpenzimet e procedurës .**

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me dt. 22.10.2015, është ushtruar ankesa e paditëses pran Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit për NSH DLB „Lavërtari dhe Blegtori ” PRZ 009- 0410, dt. 12.10.2015, me të cilën është refuzuar kërkesa e paditëses për pretendimin pronësor në ngastrën nr. .., ZK Lubizhdë, dhe ngastrën nr. .., ZK Prizren apo kompensimin në vlerë monetare, në shumën 53,000.00€.

Ka bashkangjitur :

- Vendimin e Autoriteti të Likuidimit PRZ 009- 0410.

Më dt. 09.12.2015, AKP –ja, përmes përfaqësuesit ka dorëzuar parashtresën në mbrojtje ndaj kërkesës/ankesës kundër Vendimeve të AL për NSH DLB „ Lavërtari – Blegtori ” PRZ 009-0410, me propozim që ankesa të refuzohet dhe të vërtetohet Vendimet e Autoritetit të Likuidimit .

AKP-ja në parashtresë është deklaruar se NSH DLB „ Lavërtari dhe Blegtori ” ka hyrë në procedurë të likuidimit më dt. 07.07.2014, me Vendimin e Bordit të AKP-së, ndërsa më dt. 27.08.2014, Parashtruesi ka ushtruar kërkesa pronësore për ngastrën nr. ..., ZK Lubizhdë, dhe nr. .. ZK Prizren , apo kompensimin në shumën 53,000.00€.

Autoriteti i likuidimit, më dt. 13.08.2015, i ka dorëzuar parashtruesit të kërkesës parashtresë , dhe më të njëjtën i ka kërkuar dorëzimin e informatave dhe dëshmimeve shtesë .

Autoriteti i Likuidimit mori Vendimin PRZ 009-0410 , dt. 12.10.2015, ka refuzuar kërkesën kreditore .

Vendimi është bazuar në faktet dhe bazat ligjore :

- i. Parashtruesi dështoi të parashtronte përpara Autoritetit të Likuidimit, një kërkesë të plotë, të argumentuar, dhe të mbështetur në prova,
- ii. Ky dështim u përsërit edhe pas Kërkesës për informacione shtesë që AL i dërgoi Parashtruesit,
- iii. Rrjedhimisht Kërkesa e dorëzuar nga Parashtruesi ishte dhe mbeti e pa plotë, edhe pas kërkesë për informata shtesë, dhe kërkesa u refuzua në bazë të nenit 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034.

Ka bashkangjitur :

- Kërkesa dt. 13.08.2015,
- Formulari i kërkesës 29.08.2014,
- Dëshmi prestare për pranimin e kërkesë dt. 13.08.2015.

Më dt. 10.12.2021, DHPGJS, ka lëshuar urdhër C- III- 15- 0700, për paditësen ashtu që ju është kërkuar të plotëson ankesën kundër Vendimit të AL, dhe të jep përgjigjen në parashtresën e mbrojtjes së AKP-së, 09.12.2015. Ankesa është kërkuar të plotësohet sa i përket legjitimitetit aktivë, të tregon shkaqet e ankesës, bazën juridike, të bënë identifikimin e ngastrave, me ekspertizë gjeodezike, dhe ta precizon kërkesën për çështje kryesore. Ju është kërkuar të paguaj taksën gjyqësore, dhe është udhëzuar të angazhoj avokat .

Më dt. 20.12.2021, është bërë tentim dorëzimi i Urdhrit dt. 10.12.2021, te përfaqësuesi D B në Prizren , por është konstatuar i pa njohur.

Më dt. 24.03.2022, DHPGJS ka lëshuar urdhër C- III- 15- 0700, me të cilën ka vendosur që dorëzimet dhe komunikimet, me paditësen të bëhen përmes publikimit në tabelë të shpalljeve derisa të lajmërohet në Gjykatë paditësjë ose përfaqësuesi i saj .

Më dt. 28.03.2022, deri më dt. 18.04.2022, Urdhri paditëses ju është publikuar në tabelë të shpalljeve.

Më dt. 11.05.2013, avokati S R nga Prizreni dorëzoi parashtresën me të cilën është deklaruar se ka paguar taksën gjyqësore.

Më dt. 26.05.2023, DHPGJS ka lëshuar njoftimin për paditësin dhe avokatin S R, duke i dhënë edhe një afat shtesë për plotësimin e ankesës, pasi nuk kishte vepruar sipas urdhrorit të dt. 10.12.2021.

Më dt. 31.05.2023, Njoftimi ju është dorëzuar avokatit S R

Më dt. 19.01.2024, DHPGJS, ka lëshuar Njoftimin për palët ndërgjyqës me të cilat janë njoftuar se procedura me shkrim ka përfunduar, ndërsa është caktuar seanca dëgjimore publike për dt. 25.03.2024.

Më dt. 02.02.2024, njoftimi për seancë dëgjimore publike ju është dorëzuar avokatit S R, ndërsa më dt. 29.02.2024, paditëses Hanumshah Berisha.

Më dt. 22.02.2024, avokati S R, dorëzoi parashtrësën me të cilën e ka njoftuar gjykatën se është tërheq nga përfaqësimi i palës, dhe lënda është te paditësja- djali i saj Q R.

Më dt. 25.03.2024, është mbajtur seanca dëgjimore publike në të cilën, ka munguar paditësja ndërsa pa autorizim është paraqitur avokati A K, i cili ka kërkuar të shtyhet seanca, pasi ka theksuar se dje është angazhuar nga pala paditëse përmes telefonit, dhe më ka lutur të prezantojë në seancën e sotme, nuk i kam shkresat e lëndës.

Përfaqësuesi i AKP-së, nuk kundërshtoj shtyrjen.

Në seancë publike Kolegji, mori urdhër që avokati A K, të dorëzojë autorizimin për përfaqësim të palës në afatin prej 5 ditëve, dhe të njëjtin ta dorëzojë me parashtrësë me shkrim, në të kundërtën ky avokat është njoftuar për pasojën juridike ashtu që Gjykata do të marr Aktgjykim për mosparaqitje.

DHPGJS, deri më dt. 05.04.2024, nga avokati A K nuk ju është dorëzuar autorizimi për përfaqësim ose të ketë kërkuar ndonjë afat shtesë.

Arsyetimi Ligjor

Ankesa e paditëses hedhet.

Me nenin 58 të Ligjit nr. 06/L-086, është paraparë „ 1. Nëse pala kundërshtare, të cilës i është dorëzuar kërkesa, nuk paraqitet në seancë dëgjimore për të cilën është njoftuar sipas rregullit dhe me kohë, atëherë gjyqtari(ët) gjegjës, sipas detyrës zyrtare, apo në bazë të kërkesës së Parashtruesit, mund të nxjerrë një Aktgjykim për mosparaqitje kundër palës kundërshtare. 2. Nëse parashtruesi i ftuar sipas rregullit nuk paraqitet në seancë dëgjimore apo nëse braktis procedurat, atëherë gjyqtari(ët) gjegjës mund, pas parashtrimit të kërkesës nga pala kundërshtare, të nxjerrë një Aktgjykim për mosparaqitje kundër Parashtruesit duke hedhur poshtë kërkesën dhe duke urdhëruar Parashtruesin që të paguajë të gjitha shpenzimet procedurale. 3. Para nxjerrjes së një aktgjykimi për mosparaqitje, gjyqtari(ët) gjegjës vlerëson se janë përmbushur të gjitha këto kushte: 3.1. kërkesa është e pranueshme; 3.2. faktet e pretenduara nga Parashtruesi mbështesin kërkesën;

Gjykata vlerëson se në rastin konkret, paditësja ishte e ftuar në mënyrë të rregullt pasi njoftimin për mbajtjen e seancës dëgjimore publike të caktuar për dt. 25.03.2024, ju ishte dorëzuar, më dt. 29.02.2024, dhe s' bashku me njoftim ka pranuar edhe njoftimin për pasojën juridike nëse nuk prezanton në seancë dëgjimore, në lidhje me zbatimin e nenit 58 të Ligjit nr. 06/L-086.

Avokati A K, nuk veproi sipas urdhrorit të lëshuar nga Kolegji i Specializuar i DHPGJS, në seancë dëgjimore, më dt. 25.03.2024, kështu që gjykata vlerësoi se i njëjti nuk ka pasur as autorizim për të vepruar në emër të palës paditëse në seancë dëgjimore .

Gjykata vlerëson se në rastin konkret janë përmbushur të gjitha kriteret e parapara për marrjen e Aktgjykimit për mosparaqitje sipas nenit 58, paragrafi 3, lidhur me paragrafin 2, të Ligjit nr. 06/L-086, pasi paditësja e ka pranuar njoftimin për mbajtje të seancës dëgjimore për dt. për dt. 25.03.2024, ndërsa nuk ka prezantuar .

Shpenzimet Gjyqësore:

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme , u vendos që secila palë ti heqë shpenzimet e veta të procedurës .

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi, sipas nenit 59, të Ligjit nr. 06/L-086, mund të ushtrohet kërkesë për prishje të aktgjykimit për mosparaqitje në afatin prej një muaj dite, Kërkesa i dorëzohet Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme dhe palës kundërshtare / të paditur.

Hasim Sogojeva, Gjyqtar kryesues

Gazmend Sylaj Gjyqtar

Diellza Hoxha Gjyqtare